



---

6/41-V1

*Rregullore*

*Maj/2020*

**RREGULLORE  
PËR PËRGJEGJËSIT E STUDENTËVE**

---

**PRISHTINË, Maj 2020**

Mbështetur në dispozitat respektive të LIGJIT Nr. 04/L-037 PËR ARSIMIN E LARTË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS, si dhe dispozitës së nenit 88 të Statutit të BPrAL Kolegji Presidenti më datën **15.05. 2019**, miratoi këtë:

## **RREGULLORE PËR PËRGJEGJËSIT E STUDENTËVE**

### **Neni 1.**

Më këtë Rregullore rregullohen përgjegjësitë e studentëve për shkelje të detyrave gjatë studimeve në BPrAL Kolegji UBT, caktohen masat ndëshkimore dhe shqiptimi i sanksioneve adekuate, si dhe procedura së bashku më këshillat juridike.

### **Neni 2.**

Studenti është i obliguar të përmbushi detyrat e marra, ta ruaj pasurinë e BPrAL Kolegji UBT, si dhe tu përmbahet rregullave tjera sanksionuar me Statut, këtë Rregullore si dhe akte tjera normative të "UBT-se".

Në rast të mos përmbushjes së detyrimeve, studentin mund të bartë përgjegjësi disiplinore dhe materiale.

### **Neni 3.**

Studenti mund të kryej shkelje të lehta dhe shkelje të rënda disiplinore kundrejt kryerjes ose moskryerjes të detyrimeve të ngarkuara.

### **SHKELJE TË RËNDA KONSIDEROHEN:**

- keqpërdorimet në shfrytëzimin e indeksit,
- futja e shënimeve ose heqja e paautorizuar e shënimeve në indeks dhe dokumente tjera,
- shkatërrimin ose dëmtimin e qëllimshëm të pasurisë së "UBT-se",
- shkelja e rëndë e sjelljeve vis a vis mësimdhënësve, personelin mbështetës administrativ si dhe kolegëve student,
- sjellja e pahijshme që rëndë dhe drejtpërdrejt dëmton imazhin, autoritetin dhe reputacionin e "UBT-se",
- dhënia e shënimeve të rreme me qëllim sendërtimit të të drejtave që sipas ligjit dhe akteve normative nuk i përkasin,
- përsëritje e shkeljeve të lehta më shumë se dy (2) herë gjatë studimeve.

### **SHKELJE TË LEHTA KONSIDEROHEN:**

- mospjesëmarrja në ligjëratat,
- sjellje e pahijshme gjatë ligjëratave dhe mbajtjes së provimeve,
- pengimi i mbajtjes së ligjëratave dhe provimeve,
- sjellje e pahijshme ndaj mësimdhënësve, personelit mbështetës administrativ si dhe kolegëve student,
- sjellja në kundërshtim me normat ligjore mbi ndalimin e përdorimit të duhanit,

- **sjellje tjera me të cilat dëmtohet imazhi, autoriteti dhe reputacioni i "UBT-se".**

#### **Neni 4.**

Studenti bartë përgjegjësi materiale për çfarëdo dëmi që me qëllim ose nga pakujdesia e skajshme i shkakton në ndërtesë ose pasurisë së "UBT-se".

#### **Neni 5.**

Studentit për shkelje të lehta të detyrimeve, mund të shqiptohet këto masa ndëshkimore:

- **vërejtje, si dhe**
- **vërejtje me shkrim.**

Për shkelje të rënda studentit mund ti shqiptohen këto masa ndëshkimore:

- **vërejtje para përjashtimit nga studimet,**
- **ndalim të dhënies së provimeve,**
- **ndalim ndjekjeje të ligjëratave apo pjesë të ligjëratave në kohëzgjatje me se paku 30 ditë dhe me se shumti 6 muaj,**
- **largimi nga studimet për kohë të caktuar deri 1 vjet,**
- **largim të përhershëm nga studimet.**

#### **Neni 6.**

Procedura e përgjegjësisë së studentit iniciohet nga Dekani.

Inicimin e procedurës së përgjegjësisë mund ta japi cildo mësimdhënës apo nëpunës i "UBT-se", studentet dhe qytetarët që kanë njohuri për kryerjen e veprës së ndëshkueshme.

#### **Neni 7.**

Për përgjegjësinë e studentit vendos Komisioni Disiplinor të cilin e emëron Këshilli i fakultetit, në bazë të propozimit të Dekanit.

Komisioni Disiplinor ka Kryetarin dhe dy (2) anëtar që kanë zëvendësit e tyre.

Kryetari i Komisionit Disiplinor është mësimdhënës, ndërsa një (1) anëtar dhe zëvendësi i tij zgjedhën nga radhët e mësimdhënësve, si kundër një (1) anëtar dhe zëvendësi i tij zgjedhën nga radhët e studentëve.

Anëtarët e Komisionit Disiplinor emërohet për periudhën kohore dy (2) vjeçare, me mundësi rizgjedhjeje.

#### **Neni 8.**

Procedura para Komisionit Disiplinor është publike dhe e natyrës urgjente.

#### **Neni 9.**

Me rastin e shqiptimit të masave disiplinore të përgjegjësisë merren parasysh sidomos:

- **pesha e shkeljes dhe pasoja,**
- **shkalla e përgjegjësisë së studentit,**
- **rrethanat në të cilat shkelja është kryer,**
- **sjellje e mëhershme dhe puna e suksesi i studentit,, si dhe**
- **rrethana tjera relevante për gjykim dhe shqiptim të llojit të masës dënuese.**

Nëse me shkelje është shkaktuar dëm material, Komisioni Disiplinor mund të bie vendim për kompensim dëmi, ose të japi propozim për inicim procedure për kompensim dëmi para organit kompetent.

**Neni 10.**

Parashkrimi i shqiptimit të masës së përgjegjesisë për shkelje të lehta është kalimi i periudhës kohore prej gjashtë (6) muaj, ndërsa, për shkelje të rënda është kalimi i periudhës kohore prej një (1) vjet - llogaritur nga dita e kryerjes se shkeljes.

**Neni 11.**

Kundër vendimit të Komisionit Disiplinor studenti të cilit i është shqiptuar dënimi adekuat ka të drejtë ankese Dekanit, në afat prej tetë (8) ditësh - llogaritur nga dita e pranimit të vendimit kundërshtues.

Ankesa paraqitet në formë të shkruar dhe në dy (2) kopje, dhe e cila duhet të jetë e arsyetuar mirë dhe e nënshkruar drejtpërdrejt nga studenti - si ushtruesi i ankesës.

**Neni 12.**

Vendimi i nxjerrë në procedurë ankimore, doemos duhet të përmbajë një arsyetim të thukët mbi shkaqet e refuzimit të ankesës, pastaj, këshillën juridike, si dhe konfirmimin së ditën e dorëzimit të vendimit miratuar nga organi i shkallës së dytë administrative - studentit, **vendimi është përfundimtar.**

**Neni 13.**

Shqiptimi i masës së përgjegjesisë - **largim nga fakulteti**, shënohet ne indeks te studentit, dhe vendimi mbi shqiptimin e masës së përgjegjesisë gjithashtu publikohet ne Tabelë për Shpallje të "UBT-se".

**Neni 14.**

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje merren ne procedurë të njëjtë si dhe vetë Rregullorja.

**Neni 15.**

Kjo Rregullore hynë në fuqi tetë (8) ditë pas nënshkrimit të sajë, si dhe publikimit në Tabelë për Shpallje të UBT.

**PRISHTINË,**  
**Datë, 15.05.2019 viti**

**BPrAL Kolegji UBT**  
**PRESIDENTI**  
**Prof. Dr. Edmond HAJRIZI**

---